

V E N D I M
Nr. 305, datë 1.7.1999

**PËR MARRËDHËNIET NDËRMJET MINISTRISË SË PUNËVE TË JASHTME DHE
DREJTORIVE TË MARRËDHËNIEVE ME JASHTË PRANË DIKASTEREVE**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe të nenit 3 ligjit nr. 8370, datë 9.7.1998 “ Për shërbimin e jashtëm të Republikës së Shqipërisë”, me propozimin e Ministrisë së Punëve të Jashtme, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

1. Drejtoritë e marrëdhënieve me jashtë pranë dikastereve e ushtrojnë veprimtarinë e tyre në lidhje e në bashkëpunim të ngushtë me Ministrinë e Punëve të Jashtme.

2. Drejtoritë e marrëdhënieve me jashtë pranë dikastereve kanë për detyrë:

- të informojnë menjëherë Ministrinë e Punëve të Jashtme për të gjitha problemet, me karakter politik dhe ekonomik, që dalin gjatë takimeve të drejtuesve të dikasterit me përfaqësues të trupit diplomatik të akredituar në Republikën e Shqipërisë, apo nga letrat e mesazhet, që autoritetet e huaja i dërgojnë titullarit të dikasterit;

- në bashkëpunim me Ministrinë e Punëve të Jashtme, të organizojë takimet e titullarit të dikasterit me homologët e tij brenda dhe jashtë vendit;

- të organizojë protokollin e takimeve të titullarit me delegacione të huaja apo me përfaqësues të trupit diplomatik, të akredituar në vendin tonë;

- të informojë në çdo tre muaj për planin e vizitave të delegacioneve, të kryesuara nga titullari apo nga zyrtarë të lartë të dikasterit, si dhe të delegacioneve homologe, të huaja, që do të vizitojnë vendin;

- të dërgojë çdo 3 muaj, në Ministrinë e Punëve të Jashtme, një raport të hollësishëm për të gjitha veprimtaritë me jashtë të dikasterit, duke përfshirë edhe ecurinë e marrëveshjeve dypalëshe dhe shumëpalëshe;

- të realizojë procedurat e brendshme dhe të marrë pjesë në përgatitjen e marrëveshjeve, protokolleve dhe të programeve dypalëshe, që nënshkruhen nga titullari;

- të kontaktojë rregullisht me drejtorinë e protokollit të shtetit, për të marrë miratimin për ftesat që i vijnë titullarit, për pjesëmarrjen në pritjet, me rastin e festave kombëtare, të organizuara nga përfaqësitë e huaja, të akredituara në Republikën e Shqipërisë;

- të mbajë letërkëmbim me përfaqësitë e Republikës së Shqipërisë jashtë vendit, duke vënë në dijeni Ministrinë e Punëve të Jashtme.

3. Ministria e Punëve të Jashtme ka për detyrë:

- të ndihmojë, me materiale politike dhe ekonomike, përgatitjen e vizitave dhe të takimeve të planifikuara të titullarëve të dikastereve;

- të ndihmojë, në aspektin protokollar, organizimin e vizitave në nivelin e titullarit të dikasterit;

- të japë këshillat e nevojshme për lidhjen e traktateve dhe të marrëveshjeve ndërkombëtare;

- të transmetojë, pranë përfaqësive diplomatike apo konsullore të Republikës së Shqipërisë, kërkesat që vijnë nga dikasteret e ndryshme e që ajo i gjykon të arsyeshme.

4. Drejtuesit e drejtorive të marrëdhënieve me jashtë i propozohen organit të emërtesës nga titullari i dikasterit përkatës dhe nga Ministri i Punëve të Jashtme.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI
Pandeli Majko